



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 29.

Prishtinë, më 13.11.2018 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Zenun Pajaziti, Adem Hoxha dhe Donika-Kadaj-Bujupi.

Munguan: Ismet Beqiri dhe Milaim Zeka.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit, me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.10.2018;
3. Shqyrtimi i Projekt-kodit Penal nr. 06/L-074 të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja njoftoi se komisioni për Integritet Evropian ka pranuar dy raporte me amendamente nga Komisioni për Legjislacion, Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë dhe Projektligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, duke pasur parasysh se këto dy projektligje ndërlidhen me reformën në sistemin e drejtësisë dhe agjendën e reformës evropiane, andaj nëse ka pajtueshmëri, propozoj që të plotësohet rendi i ditës.

Më pas, hapi diskutimin.

Armend Zemaj, tha se duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre projektligjeve, që lidhen direkt me direktivat e BE-së, duhet së paku një ditë të shqyrtohen dhe të shohim ndryshimin me amendamentet, pasi sot nuk janë urgjente që të shqyrtohen, nesër mund të jemi më të përgatitur.

Kryetarja konstatoi se edhe anëtarët tjerë të komisionit u pajtuan që për këto dy projektligje të mbahet nesër një mbledhje tjetër dhe të shqyrtohen.

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua i pandryshuar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.10.2018

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projekt-kodit Penal nr. 06/L-074 të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja njoftoi se është kërkesë nga ana e institucioneve tona dhe Zyrës së BE-së, që të miratohet sa më shpejt Kodi Penal, ka qenë kërkesë e përhershme e ambasadores Apostollova dhe përfaqësuesve të BE-së, në mënyrë që të kemi avancim të reformave në sektorin e drejtësisë, sektor ky i cili është i lidhur ngushtë me avancimin e agjendës evropiane, në përgjithësi, dhe me avancimin e procesit të liberalizimit të vizave, në veçanti.

Sa i përket përputhshmërisë së Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës me legjislacionin e BE-së, çështjet që adresohen me këtë Projekt-kod janë lënë në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së.

Lidhur me këtë projektligj, hapi diskutimin dhe pastaj e hodhi në votim.

Pas votimit, **kryetarja** konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projekt-kodi Penal nr. 06/L-074 i Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor dhe tha se po ashtu edhe ky projektligj është i ndërlidhur me avancimin e reformave në sektorin e drejtësisë.

Çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj, janë lënë në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së.

Lidhur me këtë projektligj, hapi diskutimin dhe pastaj e hodhi në votim.

Pas votimit, **kryetarja** konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor dhe tha se çështjet e rregulluara dhe adresuara me këtë projektligj, janë lënë në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së, dhe si i tillë, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Lidhur me këtë projektligj, hapi diskutimin dhe pastaj e hodhi në votim.

Pas votimit, **kryetarja** konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

6. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi se më datë 16 nëntor 2018, do të kemi për vizitë një delegacion të Komisionit Parlamentar për Çështje të BE-së, të Senatit të Italisë.

Ashtu siç jemi dakorduar në mbledhjen e mëparshme dhe bazuar në një draft-agjendë të përgatitur nga Drejtoria për Protokoll, komisioni ynë planifikohet që këtë takim ta realizojë ditën e premte, më datë 16 nëntor 2018, në orën 9:30.

Në vazhdim, njoftoi se më datë 26 dhe 27 nëntor 2018, do të kemi për vizitë një delegacion të Komisionit Parlamentar për Çështje të BE-së, të Parlamentit të Kroacisë.

Lidhur me këtë vizitë, do t'ju njoftojmë me kohë, për kohën e takimit.

Bazuar në takimin, të cilin e kemi realizuar me ambasadorin e gjerman dhe me përkrahjen e GIZ-it, planifikojmë që të realizojmë një vizitë zyrtare në Bundestag.

Lidhur me këtë vizitë, na është kërkuar që të propozojmë datën për mundësinë e realizimit të këtij takimi, personat të cilët dëshirojmë t'i takojmë, si dhe temat që propozojmë për diskutim.

Blerta Deliu, tha se për aq sa kemi pak informacion dhe indice, sikur jemi një hap prapa më afër datës për liberalizim, kurse komisioni ynë po mbetet i përjashtuar. Më tej, pyeti: Pse nuk ka qenë e mundur të organizohet asnjë vizitë deri më tani, a mundet dikush të bëjë më shumë që të intensifikohen veprimet dhe të realizohen disa takime?

Sepse, është shumë me rëndësi, nuk është qëllimi për të udhëtuar, por është nevoja që të shtyhet procesi, sepse edhe shumë gjëra teknike kanë ngecur dhe ne nuk po mundemi të japim maksimalisht potencialin tonë dhe angazhimin tonë, për të mbërritur, sepse është një çështje e rëndësishme për të gjithë, pavarësisht a jemi pozitivë apo opozitë. Mendoj se jemi shumë pasivë dhe kjo nuk është për fajin tonë. Kjo është duke ngecur diku dhe nuk po e dimë se ku. Andaj, a kishim mundur të diskutojmë se çka është duke ndodhur, a duhet që ne t'i shtojmë përpjekjet për të kontribuar më shumë apo ku jemi?

Fatmire Kollçaku, pajtohet se diçka ka ngecur dhe se ky komision është anashkaluar. Është koha që si komision ta rishqyrtojmë pozicionin tonë, nuk do të thotë se çdo gjë përfundon me liberalizim të vizave, këtë vit, por siç duket, kjo do të vazhdojë edhe në vitin tjetër, por nëse mendojmë të jemi pjesë e BE-së, na presin shumë sfida tjera dhe besoj se këtij komisioni duhet t'i rikthehet roli i tij, në të ardhmen, sepse për momentin është shumë i anashkaluar.

Armend Zemaj, tha se nuk dëshiroj ta paragjykoj rolin e misioneve tona diplomatike, por e kanë një dozë të përgjegjësisë dhe nuk mund të kuptoj që institucionit më të lartë, siç është Kuvendi dhe komisioneve që janë përfaqësues të popullit, misionet tona nuk janë në gjendje të aranzhojnë një vizitë e cila është e një rëndësie më të lartë. Më duket se kemi mbetur të shkojmë vetëm në ato takime që e kemi të obliguar. Ne e kemi obligim të shkojmë në Vjenë në takimin e KOSAK-ut, është komunikim ndërparlamentar i Komisionit për Integritet, por më tutje nuk po zgjerohet ai komunikim, pasi që po

pretendojmë që jemi unikë, në këtë sferë. Në këtë fazë kemi mundur, si komision, njëzëri, të tregojmë pasqyrën e politikës së brendshme, në raport me liberalizimin e vizave.

Të jem i sigurtë, nuk kam parë ndonjë barrikadim nga ana e Kryesisë së Kuvendit, sa kam marrë pjesë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kanë qenë agjenda tjera që kërkojnë koordinim shtetëror, por mbi të gjitha roli i komisionit duhet të dalë më në sipërfaqe.

Zenun Pajaziti, tha se kemi folur disa herë për këtë temë dhe kjo është përtej atij vullneti që e kemi shprehur, disa herë e kemi ftuar ministrin e Punëve të Jashtme dhe nuk ka ardhur. Po ashtu, kemi pasur njëfarë lloj sugjerimi që të shkojmë në vijë të komunikimit diplomatik, komunikimi me ambasadat tona jashtë, por edhe me ambasadat e huaja për viza, sepse kjo duhet të zhblokohet, nëse nuk vjen ministri, prapë t'i përsëritet ftesa, por edhe nëse vjen ai, nuk na e bën ndonjë agjendë, por duhet shikuar mundësitë tjera të komunikimit. Ne e kemi pasur ministren e Integritimit Evropian në komision dhe e kemi parë agjendën e tyre, që ka qenë i përfshirë vetëm Kryetari i Kuvendit, kurse nuk është i përfshirë komisioni. Është mirë që brenda Qeverisë, të ketë një komunikim tjetër dhe të shikojmë mundësinë e zhblokimit, sepse do të bëhet vonë.

Donika Kadaj- Bujupi, tha se duhet kontaktuar direkt ambasadat tona dhe t'iu bëhet presion pozitiv, në kuptimin që t'i kryejnë punët e veta. Serbia kundër nesh është aq këmbëngulëse, sa që i shfrytëzon krejt mjetet e mundshme, kurse ne nuk i shfrytëzojmë të gjitha ato mjete të pakta që i kemi në dispozicion, sepse ngec diku në administratë dhe kjo është pak e çuditshme.

Visar Ymeri, tha e kemi një problem që mendoj se mund të shtrihet në 3 rrafshë dhe duhet bërë çmos, me atë që e kemi në dorë, të kuptojmë ku është ngecja dhe të reagojmë karshi secilës.

E para, mund të jetë mbase përfaqësimi ynë diplomatik, nuk po i kryen punët si duhet, ose nuk ka ndërtuar kontakte të duhura me parlamentet atje, për të qenë efektiv në kërkesat që i ka një komision parlamentar për takimin.

E dyta, mund të jetë prapë mungesë e koordinimit, po them këtë se para dy javësh e takova rastësisht ambasadorin e Francës, e pyeta se a e ka pranuar një kërkesë nga Komisioni Evropian, ai më tha se më kanë ardhur 5 kërkesa të komisioneve të ndryshme të Kuvendit.

Por, ata është dashur të koordinohen me ne, sepse për çështjen e liberalizimit të vizave, ne gjatë muajit nëntor e kemi të domosdoshme të takohemi me parlamentarët në Francë, kurse Komisioni për Punë të Jashtme mund të takohet gjatë muajit janar ose më vonë, sepse nuk është e domosdoshme për t'u takuar tani dhe kjo mungesë e koordinimit mund të na shkaktojë problem.

E treta, që mendoj se është shumë problematike, sepse nëse ka refuzim të tillë për të na takuar nga Franca, Holanda e kështu me radhë. Ne ishte dashur të veprojmë në kuptimin, si Kuvend, dhe të dërgojmë një letër, jo si notë proteste, por t'u tregojmë se jemi pak të hidhëruar dhe nuk jemi të kënaqur me këtë trajtim, si dhe duhet të kuptojmë saktë se ku është problemi.

Armend Zemaj, u ndërlidh në diskutim lidhur me përgjegjësinë institucionale dhe tha se nëse ndonjë ambasadë e jona ka shkresë, në të cilën thuhet se nuk kemi kohë t'ju takojmë, ne ishte dashur që ta kemi atë shkresë dhe për ta parë arsyen, si dhe kërkesën e ambasadës sonë drejtuar parlamenteve.

Ismajl Kurteshi, theksoi se në herën e kaluar, u pajtuam që kryetarja e komisionit të kontaktojë me ministren e Integritimit Evropian, se çka po ndodh me atë që e kemi biseduar, po ashtu edhe me Kryetarin e Kuvendit dhe ta ftojë prapë ministrin e Punëve të Jashtme.

Po ashtu, mendoj që ambasadat tona, që me kërkesën tonë i kontaktojnë parlamentet për të aranzhuar vizitat, duhet të na dërgojnë nga një kopje të korrespondencave që i zhvillojnë, edhe ata kur i shkruajnë dhe si i shkruajnë dhe përgjigjet e tyre, që ne t'i shohim dhe ta dimë tamam, si komision, ku është faji dhe pastaj të dimë si të reagojmë. Kështu qysh janë gjërat e pasqaruara mirë, reagimet tona mund të jenë pa vend.

Kryetarja, tha se është një moskoordinim mes komisioneve dhe nuk po e di ku është ky hendek, sepse u kemi shkruar të gjitha ambasadave, Holanda në momentin e fundit na ka shkruar se nuk mund që të na presë Gjermania. Tani është një mundësi e re që është hapur përmes ambasadorit dhe janë dy takimet që vijnë përmes Senatit të Italisë dhe delegacionit kroat.

Po pajtohem që me Qeverinë kemi pasur problem, por ejani më ndihmoni ju mua, që bashkërisht ta bëjmë një zgjidhje. Lidhur me këtë, i kemi shkruar ministrit të Punëve të Jashtme, disa herë, 3 herë na është përgjigjur që ka vizita, kurse herën e fundit as që është përgjigjur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.

Përgatitur nga:
Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,
Blerta Deliu-Kodra
